



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 492/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizren, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prishtinë.

Arsyetim

Me datën 04.11.2013, LDK-ja, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendohet se, me datë 03.11.2013, në Prizren, në QV nr.2012A kemi vërejtur se familjar të kandidatës nga radhët e PDK-së lejohen të votojnë në mënyrë grupore. Parashtruesi i ankesës ka theksuar se është shkelur dispozita e nenit 33 pika j e LZP-së dhe nenit 15 pika 3 të Rregullave Zgjedhore nr.09/2013.

PZAP-i, pasi që ftoi në cilësinë e dëshmitarit Alush Gashi ka deklaruar se, sa më përket mua gjatë tërë kohës kam qenë prezent dhe nuk ka pasur asnjë problem, pasi që ne kemi qenë në korridor te dera, pra në të dy vendvotimet nuk është ankuar askush. Parashtruesi i ankesës si provë i ka bashkangjitur tri fotografi si dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 të LZP-së parashihet se : *“Mund të apeloohen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

Me ankesën e parashtruar nga LDK-ja pretendohet se në Prizren, në QV nr.2012A kemi vërejtur se familjar të kandidatës nga radhët e PDK-së lejohen të votojnë në mënyrë grupore. Gjatë procesit të votimit, mirëpo fotografitë e ofruara si dëshmi janë të përgjithshme dhe të pa qarta për tu vërtetuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë, sepse nga deklarata e dëshmitarit vërtetohet se nuk ka pasur asnjë problem, me të cilën vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 492/2013 më datën 07.11.2013.

Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.